

**Njoftim për përqendrim me të cilin Shoqëria e brokerit e sigurimit aksionar VFP SHA Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut do të fitojë kontroll të përbashkët mbi Shtëpinë e Brokerit INOVO BROKER SHA Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut**

**(lënda nr. 08-137 /2024)**

Sipas nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 30.09.2024, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim që i referohet fitimit të kontrollit të përbashkët nga Shoqëria e brokerit e sigurimit aksionar VFP SHA Shkup, me seli në bul. Koço Racin nr. 3, hyrja 2, kati 2, Shkup – Qendër, Republika e Maqedonisë së Veriut mbi Shtëpinë e Brokerit INOVO BROKER SHA Shkup, me seli në bul. Teodisi Gologanov nr. 60-1, kati 2, Shkup – Qendër, Republika e Maqedonisë së Veriut, përmes shitblerjes së aksioneve.

**-Shoqëria e brokerit e sigurimit aksionar VFP SHA Shkup** është pjesë e grupit të këshillimit financiar WVP Group nga Grac, Republika e Austrisë. Grupi VFP është pionier në fushën e shërbimeve financiare të avancuara, i pranishëm në hapësirën e Evropës Qendrore dhe Juglindore. Grupi është themeluar në vitin 1985, në Grac, Republika e Austrisë. Aktiviteti kryesor i Grupit VFP është ndërmjetësimi dhe shitja e produkteve të sigurimeve dhe financave në 15 vende të Evropës Qendrore dhe Juglindore për më shumë se 30 vjet. Përveç Republikës së Austrisë, grupi është i pranishëm edhe përmes personave juridikë në Republikën e Bosnjë-Hercegovinës, Republikën e Bullgarisë, Republikën e Kroacisë, Republikën e Ukrainës, Republikën e Moldavisë, Republikën e Moldavisë, Republika e Serbisë. R. Mali i Zi, R. Shqipëria, si dhe R. Maqedonia e Veriut.

Shoqëria e brokerit e sigurimit aksionar VFP SHA Shkup është një nga personat juridikë që bëjnë pjesë në Grupin VFP. Ajo është e themeluar në Republikën e Maqedonisë së Veriut më 16.05.2005 dhe në përpurthje me rregulloret ligjore posedon licencë për kryerjen e aktiviteteve nga Agjencia për Mbikëqyrjen e Sigurimeve të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Aksionari më i madh i kompanisë VFP SHA Shkup është WVP-Versicherungs-Vermittlungs-Ges.m.b.H, R. Austri, e cila zotëron 77,85% të aksioneve të VFP SHA Shkup. Aktiviteti kryesor i kompanisë lidhet me aktivitete për përfaqësues në sigurim dhe ndërmjetësim të sigurimeve në tregun e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Shtëpia e Brokerit INOVO BROKER SHA Shkup është anëtare e Bursës së Maqedonisë SHA Shkup dhe e Depozitarit Qendror të letrave me vlerë SHA Shkup. Ajo është e themeluar më 24.10.2005 dhe është e autorizuar për tregtim me letra me vlerë në bursën e Maqedonisë. Aktiviteti prioritar i INOVO BROKER janë aktivitetet ndërmjetësuese në funksionimin e kontratave të letrave me vlerë dhe mallrave. INOVO BROKER kryen aktivitete të blerjes dhe shitjes së letrave me vlerë sipas porosisë dhe në llogari të klientëve, vepron si mbrojtës në kuota merret me këshillim të investimeve, si dhe pranon dhe transferon porosi për blerje dhe shitje të letrave me vlerë në tregje të huaja të letrave me vlerë.

*Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.*

*Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.*

01.10.2024

Shkup